

20192393726

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR RROGË MINIMALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

### Neni 1

Në Ligjin për rrogë minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 11/12, 30/14, 180/14, 81/15, 129/15, 132/17 dhe 140/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 124/19), neni 4 ndryshohet si vijon:

“(1) Lartësia e paguar e rrogës minimale në shumë bruto për muajin mars çdo vit harmonizohet me:

- një të tretën nga rritja e rrogës mesatare të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- një të tretën nga rritja e indeksit të shpenzimeve për jetesë dhe
- një të tretën nga rritja reale e prodhimit vendor bruto, për vitin paraprak, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës.

(2) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, me mendim paraprak nga Këshilli Ekonomik Social, e publikon lartësinë e rrogës minimale në shumë bruto të harmonizuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në muajin mars çdo vit, e cila do të fillojë të paguhet me rrogën për muajin prill në vitin rrjedhës.“.

### Neni 2

Pas nenit 5-e shtohet nen i ri 5-zh, si vijon:

#### “Neni 5-zh

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i punës konstaton se subjekti i mbikëqyrjes inspektuese ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7-a të këtij ligji, është i detyruar që për parregullsinë e kryer dhe kundërvajtjen e kryer të përpilojë procesverbal në pajtim me ligjin dhe me aktvendim subjektiv të mbikëqyrjes inspektuese t’i shqiptojë vërejtje si masë inspektuese dhe të përcaktojë afat në të cilin është i detyruar t’i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë.

(2) Nëse pas skadimit të afatit të përcaktuar gjatë shqiptimit të vërejtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori konstaton se parregullsitë dhe mangësitë ende nuk janë mënjeluar, me aktvendim do ta urdhërojë kryerësin e kundërvajtjes që të punësuarve t’u paguajë rrogë minimale dhe kontribute nga rroga në pajtim me ligjin dhe jep propozim për barazim me lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse personit përgjegjës në personin juridik ose personit të autorizuar nga ai në pajtim me Ligjin për kundërvajtje. Nëse punëdhënësi nuk e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse, inspektori i punës do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse te organi kompetent.

(3) Aktvendimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, miratohet menjëherë, e më së voni në afat prej tetë ditësh nga dita e përpilimit të procesverbalit në pajtim me ligjin.

(4) Kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nuk janë përcaktuar parregullsi dhe shkelje tjera të ligjit ose rregullës tjetër, ose parregullsitë e përcaktuara janë mënjeluar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori e ndërpret procedurën me konstatim në procesverbal në pajtim me ligjin.

(5) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, inspektori mund të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim me gojë të theksuar në procesverbal në pajtim me ligjin.

(6) Në rastin nga paragrafi (5) i këtij neni, inspektori është i detyruar që menjëherë, e më së voni në afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, të miratojë aktvendim me shkrim për shqiptimin e masës inspektuese.

(7) Kundër aktvendimit nga paragrafët (1), (2) dhe (6) të këtij neni, mund të deklarohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, te organi kompetent për vendimmarrje në shkallë të dytë, në pajtim me ligjin.

(8) Ankesa nga paragrafi (7) të këtij neni, nuk e prolongon realizimin e aktvendimit nga paragrafët (1), (2) dhe (6) të këtij neni.“.

### Neni 3

Neni 7 ndryshohet si vijon:

“(1) Nëse punëdhënësi e përsërit kundërvajtjen nga neni 7-a i këtij ligji, në afat prej një viti nga dita e kryerjes së kundërvajtjes, inspektori i punës me aktvendim do ta ndalojë punën e punëdhënësit në hapësirat e punës, vendin e punës ose në mënyrë tjetër përkatëse në kohëzgjatje prej 15 ditësh, do ta urdhërojë punëdhënësin që të punësuarve t'u paguajë rrogë minimale dhe kontribute nga rroga në pajtim me ligjin dhe do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse. Gjatë kohës së ndalimit për punë, punëdhënësi është i detyruar që punëtorëve t'u paguajë rrogë minimale dhe kontribute nga rroga minimale në pajtim me ligjin. Pas skadimit të ndalimit për punë, punëdhënësi nuk guxon ta zvogëlojë numrin e të punësuarve në tre muajt e ardhshëm.

(2) Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrohet në afat prej tetë ditësh nga pranimi i aktvendimit dhe mund të deklarohet te organi kompetent për vendimmarrje në shkallë të dytë, në pajtim me ligjin.

(3) Ankesa nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.“.

### Neni 4

Neni 7-a ndryshohet si vijon:

“(1) Gjorbë në shumë prej 300 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje punëdhënësit mikro dhe të vogël - person juridik, gjorbë në shumë prej 500 deri në 600 euro për punëdhënësit të mesëm - person juridik, gjorbë në shumë prej 800 deri në 1000 euro në kundërvlerë me denarë për punëdhënësit të madh - person juridik, nëse të punësuarve nuk u paguan rrogë minimale dhe kontribute nga rroga në pajtim me këtë ligj.

(2) Gjorbë në shumë prej 150 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik të punëdhënësit mikro dhe të vogël, 300 euro në kundërvlerë me denarë të punëdhënësit të mesëm dhe 400 euro në kundërvlerë me denarë të punëdhënësit të madh.

(3) Gjorbë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - person fizik.

(4) Gjorbë në shumë prej 200 deri në 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, personit zyrtar.“.

### Neni 5

Neni 7-b ndryshohet si vijon:

“(1) Procedurë të kundërvajtjes për kundërvajtje nga neni 7-a paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji, udhëheq dhe sanksion kundërvajtës shqipton Komisioni i Kundërvajtjes të cilin e formon ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

(2) Procedurën e kundërvajtjes për kundërvajtjet nga neni 7-a paragrafi (4) i këtij ligji, e udhëheq dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

(3) Realizimi i të drejtës së mjetit juridik kundër vendimit të Komisionit të Kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe procedura për mjet juridik kundër vendimit të gjykatës kompetente nga paragrafi (2) i këtij neni, zbatohet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje."

#### Neni 6

Lartësia e rrogës minimale është 14.500 denarë në shumë neto, duke filluar me pagesën e rrogës për muajin dhjetor 2019 përfundimisht me pagesën e rrogës për muajin mars 2020.

#### Neni 7

Dispozita e nenit 1 të këtij ligji, me të cilën ndryshohet neni 4 i Ligjit për rrogë minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 11/12, 30/14, 180/14, 81/15, 129/15, 132/17 dhe 140/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 124/19), do të fillojë të zbatohet me pagesën e rrogës për muajin prill 2020.

#### Neni 8

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për rrogë minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".